

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 867120  
Datë/Datum. 30.10.20

PRISHTINË - PRIŠTINA

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

Sipas Nenet 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 701-20-5713-5-2-1

Sa i përket tenderit për Adaptimi i hapsirës për ANGIOGRAF në klinikën e Neurologjisë - QKUK.

**ANKESË**

**1. Identifikimi i ankuesit\***

**"AC inq"Sh.p.k**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

Qendra Tregtare Bregu i Diellit Nr.47-Prishtinë

*(Adresa)*

Prishtinë

*(Vendi)*

049/264-977

*(Numri Telefonit)*

10000

*(Kodi postar)*

*(Numri i Faks-it)*

Arton Cocaj

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

acing.shpk@gmail.com

*(Adresa elektronike)*



29.10.2020

*(Data e parashtrimit të ankesës)*

*(Nënshkrimi dhe vula)*

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

**2. Identifikimi i avokatit**

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

B05 Njoftim per Kontrat: 25.09.2020 ne web faqen E-prokurimit.

Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje : 05.10.2020 ,ora 12:00 ne web faqen e-prokurimit.

Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje : 08.10.2020 ,ora 12:00 ne web faqen e-prokurimit.

Vendim per Aprovim pjeserishem te Kerkeses per Rishqyrtim - Adaptimi i hapsires.pdf: 02.10.2020 ,ora 13:01 ne web faqen e-prokurimit.

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara: 05.10.2020 ne web faqen e-prokurimit.

PROCESI I HAPJES.PDF:08.10.2020 ne web faqen E-prokurimit.

Njoftimi mbi vendimin dhe letrat standarde - Adaptimi i hapsirës për ANGIOGRAF.PDF :16.10.2020 ne web faqen E-prokurimit.

KËRKESE PËR RISHQYRTIM: 19.10.2020 , ne web faqen E-prokurimit.

Vendim per refuzimin te Kerkeses per Rishqyrtim - Adaptimi i hapsirës për ANGIOGRAF: 20.10.2020 , ne web faqen E-prokurimit

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e më tutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Ne kemi bërë KËRKESË PËR RISHQYRTIM me datë 19.10.2020 përmes E-prokurimi te linku - KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Dhe me datë: 20.10.2020 e kemi pranuar përgjigjen nga AK-së që e ka ngarkuar në E-PROKURIM ku është refuzuar kërkesa jonë duke mos jepur shpjegime. (Gjeni te bashkangjitur dokumentet )

### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. Neni 1 LPP- së
2. Neni 6 LPP- së
3. Neni 7 LPP- së
4. Neni 59- LPP-së
5. Neni 60- LPP-së
6. Neni 64- LPP-së
7. Neni 69- LPP-së
8. Neni 72- LPP-së
9. Neni 108/A- LPP-së

**\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

### 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.



*Te nderuar pasi kemi pranuar " Njoftimi mbi vendimin dhe letrat standarde - Adaptimi i hapsirës për ANGIOGRAF.PDF: datë :16.10.2020 në web faqen e E-PROKURIMIT,ku na keni eliminuar me arsyetimin se:*

**Oferta e juaj nuk e plotson këto kritere:**

Komisioni konstaton se Operatori ekonomik " AC ing " SH.P.K.. Qendra Tregtare Bregu i Diellit, Lok.Nr.47, - PRISHTINË nuk e ka përbushur kriterin:

1. Nuk ka ofruar nuk ka ofruar certifikatat EN ISO 14971, OHSAS18001 dhe EN1504-2; edhe mbas kërkesës për sqarime nuk e ka plotësuar këto kritere – ka ofruar certifikata që nuk përkojnë me dokumentacionin e prodhuesit fillestar që janë derzuar në E Prokurimi.
2. OHSAS18001- jo me validitet

Sqarimet:Pasi keni kërkuar sqarime shitesë " B47 Letër Standarde e kërkeses për sqarimin e tenderit"me datë :13.10.2020 në ora 13:05 ku kërkesat kanë janë:

**Kriteri ka qen :**

1. EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 EEC dhe OHSAS18001 & EN 1504-2;

1. Sqarimi -Te sjellet deshmi për EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 EEC; te ne është prezentuar vetëm shenja CE 93 42 EEC.
2. Sqarimi -Te sjellet deshmi OHSAS18001 me validitet; te ne ne sistem me datë validiteti është vetëm deri me 27.09.2020.
3. Sqarimi -Te sjellet deshmi EN 1504-2: te ne nuk është prezentuar fare.

Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh me shkrim në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues në E- Prokurim dhe në Email brenda 3 ditëve nga data e kësaj kërkesë. **Jo ma larg se me datë 16.10.2020 ora 12:00:00**

Përgjigjja për piken e parë për certifikatën EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 ECC ju kemi ngarkuar në e-prokurimi në pjesë dorëzim në AK-së me datë 15.10.2020 në ora 14:57 me tekst të fajlit " 100-MD103-022-1501-100-0\_GMS.pdf " e cila i plotëson të gjitha si janë të cekura në FDT.(Gjeni të bashkangjitura dëshminë e EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 ECC ).

Përgjigjja për piken e dytë për certifikatën OHSAS 18001 ju kemi ngarkuar nga prodhuesi Viessmann e cila ka afatë deri me datë 27.09.2020 e cila e plotëson kushtin sepse ka afat pas njoftimit për kontratë i cili njoftim është 24.09.2020 dhe pas kërkesë nga ana juaj ne ju kemi drejtuar Distributorit për Kosovë si është " TERMOVENT"Sh.p.k për certifikatën e e re dhe ai na ka dërguar e-mail e komunikimit me prodhuesin si e ka deklaruar se jemi në proces të vazhdimit të certifikatës dhe në momentin e marrjes së certifikatës se re do ju a sjellim . Distributori i autorizuar prej Viessmann për Kosovë e posedon certifikatën ISO 45001:2008 me validitet deri me 24.06.2022 dhe dokumentin që e autorizohet nga prodhuesi për shitjen , instalimin dhe servisimin.(Gjeni të bashkangjitura dëshminë).

AK-së nuk e ka pranuar këtë certifikatë ,kurse e ka pranuar certifikatën e ISO 45001 NNSH EGO-ELSA i cili nuk është distributor për shitjen e pajisjeve të makinerisë ,sepse në dosje të tenderit është nga prodhuesi .

AK-së nuk e ka definuar certifikatën OHSAS 18001 a e kërkon për pajisje të makinerisë apo për pajisje medicinale ,sepse te ne kanë kërkuar sqarim siç shiften me lartë për pajisje të makinerisë kurse te GOE i propozuar për kontratë e kanë pranuar certifikatën e ISO 45001 e cila nuk është nga prodhuesi as i pajisjeve të makinerisë e as i pajisjeve medicinale po i kompanisë NNSH EGO-ELSA .

Përgjigjja për piken e tretë për certifikatën EN 1504-2 ne nuk e kemi prezentuar për arsye se ky standard ka të bëjë me forcim të betonit dhe nuk lidhet me epoxit dhe në paramas nuk kemi pozicion për permirsimin e betonit ,mirëpo pasi ju kemi kërkuar dhe është dokument që ekziston me datë me heret para njoftimit për kontratë sipas nenit 72 ne ju kemi ngarkuar në e-prokurimi në pjesë dorëzim në AK-së me datë 14.10.2020 në ora 14:28 me tekst të fajlit " Certifikata.rar" e cila i plotëson të gjitha si janë të cekura në FDT.(Gjeni të bashkangjitura dëshminë).

GOE i propozuar për kontratë nuk i posedon këto dokumente të cekura me poshtë:

1. Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM nuk e permban emrin e tenderit as numrin e prokurimit te dy operatorve.
2. (2.2 Dokumentet e firmes SH.P.K. ARTECH) nuk e ka te vazhdume ne ARBKO po e ka ngarkuar te vjetren.
3. (2.1 Dokumentet e firmes N.N.SH. EGO-ELSA) ne informata mbi biznesit te ngarkume e ka aktivitetin primarë "Agjencitë e patundshmërive" dhe kërkon nuk e ka ne aktivitet "Zhvillimi i projekteve të ndërtimit" ,prandaj projekti ka te bejë me renovim dhe ndertim e jo me shitje .
3. (4.1 Lista e kontratave AR-TECH)-tek lista e ngarkuar nuk është e vulosur siç kërkohet me ligj edhe ne projektet e prezantuar shihet se nuk ka te bejë me punë te ngjajshme siq kërkohet ne FDT.
4. Kërkesa ne FDT-2 Inxh.i dipl. i Arkitektures-Ndërtimit 5 vjetë përvojë pune pas diplomimit ka bashkangjitur inxh e arkitektures Besmir Ajetin i cili ka diplomuar me datë :20mars 2019 i cili nuk e plotëson kushtin e FDT-së.
5. Kërkesa ne FDT- Inxh.i dipl. i Makinerisë- termoenergjetikës 5 vjetë përvojë pune pas diplomimit ka bashkangjitur inxh e arkitektures Faton Behrami i cili ka diplomuar me datë 12 mars 2020 i cili nuk e plotëson kushtin e FDT-së.
5. Kërkesa ne FDT- Certifikatat e prodhuesit për pozicionet e Klimatizimit dhe ventilimit dhe sisteme medicinale dhe atë EN ISO 9001, EN ISO 13485, EN ISO 14971 me shenjë CE 93 42 EEC dhe OHSAS18001 , ka bashkangjitur certifikaten ISO 45001 NNSH EGO-ELSA e kompanisë e cila nuk i plotëson kushtin e FDT-së sepse është kërkuar nga prodhuesi e NNSH EGO-ELSA nuk prodhon Termopompa e as klimakomora siç kërkohet ne paramase .

Prandaj te gjitha pikat e cekura nuk i plotëson siç kërkohet ne Njoftimin per kontrate dhe ne FDT. **(Gjeni te bashkangjitura dëshmin).**

*Andaj ju si AK-se nuk e keni respektu nenin 59 të LPP-së ,sepse na keni eliminuar neve si OE edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe te njoftimit për kontratë,ndërsa e kemi plotësuar edhe kriterin kryesore për dhenie të kontratës,e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ultë sipas nenit 60 paragrafit 1.1 i LPP-së.*

*Ju si AK-së në këtë vlerësim dhe vendim na keni diskriminuar neve si OE në kundërshtim me nenin 7-të LLP-së dhe njëkohësisht e keni favorizuar GOE të rekomanduar për kontratë,ndërsa në paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së parashihet qartë "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo -diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".*

*Ju si AK-së është dashur ta keni në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së,pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën me efikase ,më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit te fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

*Gjithashtu ju si AK-së nuk e keni respektuar edhe nenin 6 të LPP-së,sepse jeni te obliguar që të siguronit se fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike,njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.*

***Duke i treguar argumentet e cekura me lartë kërkojm të anulohet vendimi për dhënjë për GOE,dhe të na shpallni ne si OE fitues të përgjegjshem me çmim më të ultë.***

***Në fund kërkojmë nga OSHP-ja ,që të nxjerr:***

#### **VENDIM**

***Aprovohet ankesa e OE "AC ING"Sh.p.k e bazuar.***

***Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së.***

***Te nxjerret vendimi nga OSHP-ja ku ne të shpallemi fitues si OE i përgjegjesh me çmim më të ultë.***



*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

1. Humbja e imazhit të kompanisë për projekte në vazhdim
2. Humbja në kohë në mos nënshkrimin e kontratës dhe fillimit të punimeve
3. Kostoja financiare e sigurimit të tenderit
4. Kostoja e stafit kryesor dhe stafit teknik

#### **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*